

V E N D I M
Nr. 31, datë 28.1.2002

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.66, DATË 24.2.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KËSHILLAT MBIKQYRËS TË SHOQËRIVE ANONIME
SHTETËRORE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me ligjin nr.8237, datë 1.1.1997, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Paragrafi i dytë i pikës 3 të vendimit nr.66, datë 24.2.2000 të Këshillit të Ministrave "Për këshillat mbikqyrës të shoqërive anonime shtetërore", të formulohet si më poshtë vijon:

"-Shpërblimi për pjesëmarrje në këshillat mbikëqyrës, për kryetarin, të jetë në masën 30 për qind e pagës mujore të drejtorit të shoqërisë dhe në masën 20 për qind për anëtarët e tjerë të këshillit mbikqyrës, ndërsa për shoqëritë anonime shtetërore, që e kanë dhënë pasurinë tërësisht me qira apo emfiteozë, kryetari i këshillit mbikqyrës shpërblehet në masën 7 për qind të pagës mujore të drejtorit të shoqërisë dhe anëtarët e tjerë të këtij këshilli në masën 5 për qind të pagës mujore të drejtorit të shoqërisë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta